



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

---



**UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI: MËSIMDHËNIE E GJUHËS DHE LETËRSISË  
SHQIPE**

**AKREDITIMI**

**RAPORT VETËVLERËSIMI**

Shkurt 2021, Gjilan

AKA | Qendra e Studentëve, kati 2-të, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel. +381 38 213722 | Fax +381 38 213087 | [www.akreditimi-ks.org](http://www.akreditimi-ks.org)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

---

Duke u bazuar në kërkesën dhe udhëzimet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), stafi akademik i Fakultetit të Edukimit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan ka përgatitur këtë raport të vetëvlerësimit me të cilin aplikon për riakreditimin e programit të nivelit baçelor Programi Parashkollor.

Fakulteti i Edukimit në AKA aplikon me katër programe studimi, përkatësisht me dy programe të nivelit baçelor për riakreditim (Programi Fillor dhe Programi Parashkollor) dhe me dy programe të nivelit master për akreditim të ri (Programi *Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe* dhe Programi *Mësimdhënie dhe Kurrikula*)

Për hartimin e raporteve të veçanta për secilin nga katër programet Këshilli i Fakultetit të Edukimit më 17.10.2019, në udhëheqjen e dekanit Prof. asoc. dr. Merxhan Avdyli, ka themeluar grupin e gjerë punues. Në të nijetin takim Këshilli i Fakultetit të Edukimit ka caktuar katër grupe punuese për secilin program veç e veç, ku është vendosur që koordinatore e grupit punues për hartimin RVV-së nga Fakulteti i Edukimit të jetë Prof. ass. dr. Shpresë Qamili.

Në grupin punues për hartimin e raporteve vetëvlerësuese të Fakultetit të Edukimit janë angazhuar:

Prof. ass. dr. Shpresë Qamili, përgjegjëse për Programin Fillor

Prof. asoc. dr. Nevrije Ismaili, përgjegjëse për Programin Parashkollor

Prof. asoc. dr. Merxhan Avdyli, përgjegjës për programin *Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe*

Prof. ass. dr. Voglushe Kurteshi, përgjegjëse për programin *Mësimdhënie dhe Kurrikula*

Prof. dr. Bajram Kosumi

Prof. asoc. dr. Bashkim Dalipi

Prof. ass. dr. Emin Krasniqi

Prof. ass. dr. Nerxhivane Krasniqi

Prof. ass. dr. Mensur Neziri

Prof. asoc. dr. Musa Ajeti

Prof. ass. dr. Teuta Agaj

PhD. can. Ahmet Ibrahim

PhD. can. Drita Kryeziu

MA Xhevat Bekteshi, koordinator për mësimin praktik

Besart Rexhepi, nga alumni

Shyhrete Krasniqi, zyrtare në DKA në Gjilan

Arjeta Rexhepi, zyrtare për studentë

Kushtrim Demi, jurist në UKZ

Bartës i Programit *Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe*

Prof. asoc. dr. Merxhan Avdyli, përgjegjës



## TABELA E PËRMBAJTJES

1.	HYRJE .....	5
1.1.	Një vështrim i shkurtër i institucionit dhe programit në vlerësim .....	6
2.	VLERËSIMI I PROGRAMIT .....	17
2.1.	Misioni, objektivat dhe administrimi .....	17
	Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administratën: .....	21
2.2.	Menaxhimi i cilësisë .....	23
	Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë: .....	25
2.3.	Stafi akademik .....	28
	Analiza SWOT për stafin akademik: .....	30
2.4.	Përmbajtja e procesit arsimor .....	31
	Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit arsimor: .....	32
2.5.	Studentët .....	33
	Analiza SWOT për studentët: .....	36
2.6.	Hulumtimi .....	37
	Analiza SWOT për hulumtim: .....	45
2.7.	Infrastruktura dhe burimet .....	46
	Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet: .....	50
3.	EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMI I KOHËVE TË FUNDIT I REGJISTRUAR QË NGA VLERËSIMI I MËPARSHËM (nëse ka) .....	51
4.	SHTOJCAT .....	52



## Lista e tabelave

Tabela 1. Njësitë akademike dhe organizative të UKZ, numri i programeve që ofrohen dhe gradat përkatëse që fitohen pas përfundimit të studimeve .....	9
Tabela 2. Procesi i akreditimit të UKZ dhe programeve studimore 2013-2021.....	10
Tabela 3. Numri i studentëve të regjistruar në vitet 2013-2020 .....	13
Tabela 4. Forma e notimit në UKZ .....	16
Tabela 5. Pasqyra e programit për akreditim: Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe .....	17
Tabela 6. Numri i mësimdhënësve të gjuhës shqipe të pensionuar në 5 vitet e fundit dhe atyre që do të pensionohen në 5 vitet e ardhshme .....	19
Tabela 7. Stafit akademik në programin Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe .....	28
Tabela 8. Informatat për programin e studimit në vlerësim: Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe .....	31
Tabela 9. Krahasueshmëria e lëndëve në nivel ndërkombëtar .....	32
Tabela 10. Publikimet e stafit akademik .....	39
Tabela 11. Zyrat e KD, menaxhmentit, dekanëve, stafit akademik, stafit administrativ, parlamentit studentor dhe depo .....	47
Tabela 12. Sallat e mësimi, kabinetet e informatikës dhe laboratorët .....	47
Tabela 13. Numri total i kompjuterëve (desktopë dhe laptopë) funksionalë që disponon universiteti .....	48
Tabela 14. Numri total i pajisjeve të tjera teknologjike funksionale që disponon universiteti .....	48
Tabela 15. Pajisje të mundësuar nga grante dhe projekte të ndryshme .....	49



## 1. HYRJE

Ky Raport Vetëvlerësimi (në tekstin e mëtutjeshëm RVV), është përgatitur nga Fakulteti i Edukimit i Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan (në tekstin e mëtutjeshëm UKZ), duke u bazuar në Udhëzuesin e AKA-së për përgatitjen e RVV-ve për njësinë akademike. Qëllimi i këtij raporti ka të bëjë me përgatitjet për akreditim të programit të nivelit master **Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe**.

Programi master **Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe** për zhvillim të mëtutjeshëm të procesit mësimor udhëhiqet në bazë të dokumenteve si në vijim:

- *Deklarata e Bolonjës;*
- *Standardet dhe Udhëzimet e Sigurimit të Cilësisë në Fushën e Arsimit të Lartë Evropian, Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë(AESC)*
- *Konventa e Lisbonës;*
- *Ligji i Kosovës për Arsimin e Lartë;*
- *Statuti i Përkohshëm i Universitetit “Kadri Zeka”;*
- *Udhëzimet e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës.*

Programi i studimit në vlerësim **Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe** është në harmoni me këto dokumente strategjike:

- *Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë, janar 2016);*
- *Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 (Qeveria e Republikës Kosovës, Prishtinë, 7.12.2016);*
- *Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit të UKZ 2017-2022*
- *Plani i veprimit i Fakultetit të Edukimit 2019-2020;*
- *European Commission: From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in Kosovo, 23.12.2016;*
- *Pasqyra e pensionimit të kuadrit arsimor, periudha 2014-2024 (Hulumtimi i Fakultetit të Edukimit, 2019);*
- *Hulumtimi për studentët e diplomuar në Fakultetin e Edukimit në UKZ (Raport i Fakultetit të Edukimit, 2019).*
- *Hulumtimi i tregut të punës në Kosovë, rajon dhe në BE:*
  - a. *Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetarët statistifikor të cdo viti; *Statistikat Afatshkurtra të Industrisë*;*



- b. European Comision, *From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs In the Western Balkans*,
- c. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arsimi dhe Tregu i Punës në Kosovë dhe Bashkim Evropian

Programi master ***Mësimdhënie e gjuhës dhe letërsisë shqipe*** bazohet edhe në disa arsye dhe veçanti të cilat paraqesin një rëndësi të madhe për zhvillimin e arsimit në Republikën e Kosovës:

- Nevojat e mëdha të sistemit arsimor parauniversitar të Kosovës, si në nivelin e mesëm të ulët po ashtu edhe në atë mesëm të lartë për mësimdhënës më me kompetencë të gjuhës dhe letërsisë shqipe;
- Kërkesa për një alternativë tjetër të re programore të qasjes në mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Republikën e Kosovës;
- Ngritja e nivelit të mësimin të gjuhës dhe letërsisë shqipe në Republikën e Kosovës;
- Plotësimi i kuadrit të pensionuar të mësimdhënësve të gjuhës dhe letërsisë shqipe jo vetëm në rajonin e Gjilanit dhe të Ferizajit, por edhe nga Lugina e Preshevës dhe nga e gjithë Republika e Kosovës;
- Mbulimi me kuadrin e ri arsimor në mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë shqipe në rajonin e Gjilanit, Ferizajit, por edhe në gjithë Republikën e Kosovës.

### 1.1. Një vështrim i shkurtër i institucionit dhe programit në vlerësim

UKZ u themelua me vendimin e Qeverisë së Kosovës numër 118/03 të datës 6 mars 2013, i cili nga KK u miratua më 30 maj 2013.

Vendimi i Kuvendit të Kosovës realizoi synimin dhe punën disa dekadëshe që është bërë në Gjilan me arsimin e lartë, prej vitit 1958 kur u themelua Qendra për Aftësimin e Mësimdhënësve (shkollë për përgatitjen e mësuesve).

Themelimi i UKZ-së bëri të mundur përfshirjen në shkollimin e lartë universitar të numrit më të madh të studentëve në Lindje të Kosovës, të Luginës së Preshevës (Serbi), rajonit të Kumanovës (Maqedonia Veriore) si dhe të viseve të tjera nga Kosova.

Më 10 dhjetor të vitit 2020 KK ka miratuar Statutin e UKZ, me të cilin dokument, UKZ fiton pavarësinë administrative dhe përfundimisht bëhet i pavarur nga MASH.

UKZ bartë idenë e promovimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë universitar, kërkimeve shkencore, krijimtarisë artistike dhe kualifikimin e kuadrave deri në gradën e doktoratës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

---

Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan është krijuar për të qenë në shërbim të dijes, të edukimit dhe të mirëqenies së shoqërisë kosovare dhe të mbarë njerëzimit.

Mbështetur në vizionin dhe në misionin e vet, UKZ është ura lidhëse midis vlerave lokale, vlerave nacionale dhe vlerave globale. Ai është dera më e mirë e Kosovës për në epokën e teknologjisë digjitale dhe për një shoqëri multikulturore. UKZ, duke i qëndruar besnik vetë thelbit të fjalës universal, do të nxisë dhe respektojë multikulturalizmin dhe diversitetin.

UKZ ka impakt të drejtpërdrejtë në shoqëri, dije, shkencë, familje, ekonomi, mirëqenia dhe në demokracinë e shoqërisë sonë e më gjerë. Të gjitha objektivat e UKZ, në përputhje me misionin e vet, orientohen drejt këtij roli të UKZ në shoqëri.

Misioni i UKZ është përshtatur me tre shtyllat kryesore: mësimdhënie, hulumtim dhe shërbim në komunitet.

UKZ vazhdimisht punon për të krijuar cilësi të lartë, në të gjitha aktivitetet e saj, për të siguruar dhe përmirësuar kualitetin në mësim, studim dhe hulumtime shkencore, duke monitoruar dhe vlerësuar performancën e stafit akademik dhe duke krijuar kushtet e mësimnxënies për studentët.

Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan është krijuar për të qenë në shërbim të dijes, të edukimit dhe të mirëqenies së shoqërisë kosovare dhe të mbarë njerëzimit.

Ky është vizioni ynë: **Universiteti ynë është mundësia më e mirë për krijimin dhe avancimin e vlerave themelore njerëzore, për secilën kohë dhe në çdo hapësirë.**

Vetëm duke krijuar vlera të larta shkencore, kulturore, ekonomike e sociale ne e ndihmojmë shoqërinë tonë në ballafaqim me shekullin e teknologjisë informative dhe të globalizmit.

Misioni i UKZ është përshtatur me tre shtyllat kryesore: mësimdhënie, hulumtim dhe shërbim në komunitet.

Misioni i UKZ është:

Tempull i dijes i cili kultivon nxënien dhe zhvillimin e dijeve, nxit mendimin kritik dhe shpirtin e ndërmarrësisë për hulumtime të reja, të cilat e ndihmojnë zhvillimin shoqëror dhe atë teknologjik, përgatit të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të qenë pjesë e një shoqërie virtuale dhe globale, pjesë e një tregu të hapur të punës dhe njëkohësisht, model për anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Ky mision është i mbështetur në disa shtylla: mësimi dhe dija; nxitja e mendimit kritik, shpirti i ndërmarrësisë, hulumtimit, zhvillimi teknologjik, ndihma në komunitet, shoqëria virtuale, globalizmi dhe tregjet e hapura të punës. Ky mision e shpreh shumë qartë orientimin e një universiteti të ri e bashkëkohor, i gatshëm të ballafaqohet me botën virtuale e globale, njëkohësisht duke pasur kujdes e duke i zhvilluar vlerat themelore të shoqërisë njerëzore.

Prandaj, UKZ ka rol dhe përgjegjësi të veçantë në përparimin dhe zhvillimin e pasurisë intelektuale, shkencore, artistike dhe kulturore , si dhe në forcimin dhe zhvillimin e



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

---

bashkëpunimit të ndërsjellë me institucionet përkatëse të botës në fushën e dijes dhe hulumtimeve shkencore.

Për këtë qëllim, UKZ ka hartuar **Strategjinë Zhvillimore dhe Planin e Veprimit 2017-2022**, e cila është miratuar nga Këshilli Drejtues në muajin maj 2017, të cilat përmbledhin punën, të arriturat, sfidat dhe synimet e së ardhmes së UKZ-së.

UKZ ofron kushte të barabarta për fitimin dhe gjenerimin e dijes, e cila reflektohet në mosdiskriminimin e askujt.

Kreativiteti i reflektuar në ide të reja dhe forma të shprehjes, kureshtja intelektuale, gatishmëria për t'u ballafaquar me rreziqe dhe frymën sipërmarrëse, reflekton në aderimin tonë me standardet më të larta etike në sjelljen personale dhe profesionale.

Në UKZ janë zhvilluar debate për ndryshimin gradual të qasjes mësimore: nga qasja klasike e memorizimit të të dhënave kah nxitja e mendimit kritik. Stafi akademik tashmë e kupton se në botën e teknologjisë informative shpjegimi klasik i profesorit në klasë e ka humbur rëndësinë, pasi studenti në çdo çast mund të ndjek të njëjtën ligjëratë nga shumë profesorë të tjerë në internet. Prandaj profesori duhet ta ndryshojë qasjen: ai duhet të nxisë studentët të mendojnë në mënyrë kritike për temat që synon t'ua shpjegojë, t'i nxisë vetë ata ta shpjegojnë dhe ta kuptojnë thelbin e temës. Në këtë mënyrë profesori shndërrohet në çelës të dijes, në vend të posedues dhe shpërndarës i dijes, si ka qenë që nga koha e Humanizmit dhe Renesancës.

Angazhimi i UKZ-së për transparencën dhe llogaridhënien në qeverisje dhe në aktivitetin akademik, krijon qëndrueshmërinë e reflektuar në angazhimin tonë të përbashkët për të udhëhequr me shembull në qasjen tonë ndaj planifikimit përgjegjës akademik dhe financiar. UKZ gjithmonë kërkon përsosmëri, sepse kupton rëndësinë e të menduarit kritik, disiplinën dhe përgjegjësinë, andaj synohen dhe priten standarde të larta për institucionin dhe studentët e UKZ-së.

Në UKZ zbatohet organizimi i kurrikulave (planprogrameve studimore) bazuar në sistemin e tri cikleve të arsimit të lartë, Sistemin Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) dhe zbaton të gjitha rekomandimet e procesit të Bolonjës.

UKZ ka 5 (pesë) fakultete dhe 1 Njësi Organizative (Biblioteka Universitare) dhe aktualisht, në këto fakultete ofrohen 10 programe studimore: 8 programe të nivelit BA dhe 2 programe të nivelit MA.

UKZ ka në proces të ri/akreditimit edhe 12 programe studimi, prej të cilave në proces të ri akreditim ka gjashtë programe: Fillor dhe Parashkollor (BA), Shkencat Kompjuterike (BA), Finance dhe Kontabilitet i Aplikuar (BA), E-qeverisje (MA), Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike (MA) si dhe për akreditim po ashtu ka në proces gjashtë programe të reja: Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (MA), Mësimdhënie e Kurrikula (MA), Kontrolla





e Sistemeve dhe Inteligenca Artificiale (MSC), Menaxhim dhe Ndërmarrësi (MSC), Juridiko-Penal (MSc), Administrimi dhe e Drejta e Unionit Evropian (BSc).

Me tabelën në vijim paraqesim fakultetet, emërtimet e programeve dhe gradave përkatëse që fitohen pas përfundimit të studimeve në këto programe:

**Tabela 1. Njësitë akademike dhe organizative të UKZ, numri i programeve që ofrohen dhe gradat përkatëse që fitohen pas përfundimit të studimeve**

Nr.	Fakulteti	Programi i studimit	Niveli i studimit	Grada që fitohet
1.	Fakulteti i Edukimit	Parashkollor	BA	Baçelor i arsimit parashkollor
		Fillor	BA	Baçelor i arsimit fillor
2.	Fakulteti Juridik	Juridik i përgjithshëm	LLB	Jurist i diplomuar
3.	Fakulteti Ekonomik	Banka financa dhe kontabilitet	BSc	Baçelor i bankave financave dhe kontabilitetit
		Menaxhment	BSc	Baçelor i menaxhmentit
		Marketing	BSc	Baçelor i makertingut
4.	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Shkencat kompjuterike	BA	Baçelor i shkencave kompjuterike
5.	Fakulteti i Shkencave Aplikative	Matematikë Arsimore	BA	Baçelor i Matematikës Arsimore
6.	Fakulteti i Sh. Kompjuterike Fakulteti Juridik Fakulteti Ekonomik	E- Qeverisja	MA	Master i E- qeverisjes
7.	Universiteti i Gjilanit Universiteti i Prizrenit Universiteti i Pejës	Qeverisja lokale dhe shoqëria demokratike	MA	Master i Qeverisjes Lokale dhe Shoqërisë Demokratike

Në tabelën e mëposhtme jepet rrjedha e procesit të akreditimit të UKZ, si institucion dhe të programeve studimore:



**Tabela 2. Procesi i akreditimit te UKZ dhe programeve studimore 2013-2021**

Fakulteti	Programi i studimit	Hera e parë	Riakreditimi
Akreditimi institucional		2014	2017
Fakulteti i Edukimit	Arsimi Parashkollor (BA)	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10.2016-30.09.2020
	Arsimi Fillor (BA)	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10.2016-30.09.2020
Fakulteti Ekonomik	Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA)	01.10.2014 - 30.09.2017	01.10. 2017-30.09.2021
	Menaxhmenti (BA)	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10. 2016-30.09.2020
	Marketingu (BA)	01.10.2014 - 30.09.2017	01.10. 2017-30.09.2021
Fakulteti Juridik	Juridik i Përgjithshëm (BA)	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10.2016-30.09.2020
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Shkencat Kompjuterike (BA) Specializimi: IE dhe SEW	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10.2016-30.09.2020
Fakulteti i Shkencave Aplikative	Matematika arsimore (BA)	1.10.2019-30.11.2022	
FSHK – FEK - FJ	E- qeverisja	01.10. 2017-30.09.2021	
UKZ – UPZ - UHZ	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	01.10. 2017-30.09.2021	

**Duke e parë si një nevojë të domosdoshme ngritjen profesionale të mësimit të mesimdhënësve UKZ, në kuadër të Fakultetit të Edukimit, ka përgatitur programin master *Mësimdhënie e gjuhës dhe letërsisë shqipe*, me të cilin program do të përmbushë një nga detyrimet e arsimit të lartë në Kosovë, e që është përgatitja e mësimit të mesimdhënësve të gjuhës dhe letërsisë shqipe në një frymë të re të zhvillimeve të përgjithshme të arsimit të lartë.**




- *Udhëheqja institucionale, strukturat e menaxhimit dhe marrëveshjet e administratës dhe personelit*

Universiteti organizohet dhe qeveriset në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, në bazë të Statutit të UKZ dhe në bazë të rregulloreve përkatëse të UKZ. Universiteti përbëhet prej njësive akademike, të cilat qeverisen dhe administrohen në tri shtylla kryesore: KD, Senati dhe administrata. Rektori është autoriteti kryesor menaxhues.

Organizimi i strukturave vendimmarrëse në çështjet akademike bëhet konform Statutit të Universitetit. KD merr vendime për hapjen dhe mbylljen e programeve studimore dhe njësive akademike. Për të gjitha çështjet akademike vendos Senati i Universitetit, të cilin e kryeson rektori. Anëtarët e Senatit zgjidhen nga NJA të Universitetit, nga administrata dhe nga Parlamenti i Studentëve.

KF udhëheq dhe merr vendime për të gjitha çështjet akademike të Fakultetit. Dekani është menaxheri kryesor i Fakultetit dhe ai e prezanton Fakultetin në Senatin e UKZ

KF propozon programin studimor të ri i cili i dërgohet Komisionit të Studimeve për shqyrtim. Komisioni i Studimeve e shqyrton, e refuzon apo e propozon për miratim në Senatin e UKZ-së. Senati i UKZ-së e aprovon ose e refuzon propozimin e KF. Këtë mënyrë të organizimit e paraqesim në mënyrë skematike, si në vijim:



Emërtimet e titujve për personelin akademik, bazuar në Statutin e UKZ-së, janë:

- Prof. dr. (profesor i rregullt)
- Prof. Asoc. dr. (profesor i asociuar)
- Prof. Ass. dr. (profesor asistent)



- Ligjërues
- Lektor
- korepetitor
- Ass. (asistent universiteti)

UKZ në vitin 2020 ka 45 staf akademik, prej të cilëve 2 janë ligjërues të lëndëve të arteve (Master of Arts), 4 janë asistentë (PhDcand.) dhe të tjerët janë doktor shkencash. Ky është një zhvillim i madh, kur të kihet parasysh fakti që në vitin 2016 UKZ ka pasur 4 profesorë me kontratë të plotë, 3 me gjysmë normë dhe disa asistentë. Gjatë këtyre viteve UKZ ka zhvilluar çdo vit akademik nga një konkurs për rekrutim të stafit të ri akademik dhe ka përkrahur asistentët që të përfundojnë me sukses studimet e doktoratës. Po ashtu, edhe 4 asistentët aktualë janë në prag të përfundimit të studimeve të doktoratës.

Edhe gjatë viti 2020/21 UKZ ka hapur konkursin për rekrutim edhe të 13 stafi të ri akademik. Një kujdes të madh UKZ i ka kushtuar në këtë periudhë edhe avancimit të stafit akademik: gjatë vitit 2019/20 janë avancuar në tituj akademikë një numër i konsiderueshëm ti stafit akademik, e po ashtu edhe në vitin vijues 2020/21 është hapur konkursi për avancime të tjera. Të gjitha procedurat e avancimit bëhen në mënyrë transparente, duke respektuar në mënyrë strikte Rregulloren për pranimin në punë dhe avancimin e stafit akademik dhe udhëzimeve administrative të MASH, të cilat paraqesin revistat dhe platformat e indeksimit të revistave ku duhet të publikojë stafi akademik për avancim.

Stafi administrativ, përfshirë edhe sekretarin e përgjithshëm, i cili është menaxheri kryesor i administratës, ka 32 zyrtarë, të ndarë nëpër njësi të veçanta. Edhe në këtë pikë UKZ ka shënuar rezultat të preکشëm: në vitin 2016 UKZ ka pasur 16 zyrtarë administrativ dhe nga viti 2018 e këndej janë rekrutuar edhe 16 zyrtarë të tjerë, duke e bërë administratën e UKZ shumë më efikase. Po ashtu, UKZ ka një plan të rritjes edhe më tej të numrit të zyrtarëve, duke marrë me prioritet: Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Zyrën për Cilësi dhe Zhvillim Akademik, Bibliotekën Universitare etj. Po ashtu, UKZ ka planifikuar gjatë vitit 2021 edhe themelimin Zyrës për Projekte, Zyrës për hulumtime Shkencore.

Kampusi i UKZ është në rrugën “Zija Shemsiu”, në qendër të Gjilanit. Ai përbëhet prej dy objekteve të mëdha, të bashkuara në rikonstruktim. Kampusi është në kufi me kampusin e shkollave të mesme të qytetit, duke e shndërruar gjithë zonën në zonë shkolllore, dhe universitare. Kampusi nuk i plotëson të gjitha nevojat në zhvillimin dinamik të UKZ, prandaj Komuna e Gjilanit dhe Qeveria e Kosovës janë duke gjetur një zgjidhje për një kampus të ri të universitetit, e po ashtu edhe brenda kampusit të tashëm në vitin 2020 janë shtuar hapësira të reja mësimore dhe bibliotekare.



- ***Studentët e tij, prejardhja e tyre socio-ekonomike dhe informatat përkatëse kontekstuale rreth fushës në të cilën vepron institucioni***

UKZ është i hapur dhe nxitë të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet formale për t'u regjistruar në studime universitare, në programet të cilat akreditohen. Studimet zhvillohen në gjuhën shqipe. Procesi mësimor në UKZ zhvillohet prej orës 8.30 deri në orën 18.00, ndërsa për studimet master vazhdon deri në ora 20.00.

Në konkurset e rregullta për pranimin e studentëve të rinj, ftohen kandidatët të cilët kanë të kryer shkollën e mesme, pa ndonjë kufizim gjinie apo përkatësie tjetër. Në bazë të Statutit të UKZ, realizohen dy konkurse për pranimin e studentëve të rinj, në qershor dhe shtator. Numri më i madh i studentëve është nga rajoni i Gjilanit, Kamenicës, Novobërdës, Vitisë, Ferizajit, Kaçanikut, Hanit të Elezit, Partesh, Klllokot, Ranillug, por edhe një numër i konsiderueshëm është nga rajonet e tjera të Kosovës, sidomos në programet master, si dhe nga Serbia (komunat: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë) dhe nga Maqedonia Veriore (Kumanovë).

Pritet që për vitin akademik 2020/21 të ketë një interesim të shtuar nga studentët e rajonit të Kumanovës pasi që rruga Kumanovë-Gjilan është lëshuar për qarkullim me hapjen e pikëkalimit kufitar në Stançiq mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

UKZ rezervon kuota të veçanta për pranimin e studentëve nga komunitetet e vogla (serbë, turq, romë) apo nga komunat jashtë Kosovës (Serbi dhe Maqedoni e Veriut), si dhe lehtësira për pranimin e personave me nevoja të veçanta.

Që nga themelimi e deri më tash në UKZ janë regjistruar gjithsej 8174 studentë.

**Tabela 3. Numri i studentëve të regjistruar në vitet 2013-2020**

Viti akademi k / Fakulteti	2013/14	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19	2019/20	2020/21	Total i
FED	401	210	277	221	202	196	167	199	<b>1873</b>
FJ	454	372	296	272	257	226	203	178	<b>2258</b>
FEK	608	608	497	386	245	244	234	235	<b>3057</b>



FSHK		96	91	115	96	73	63	76	<b>610</b>
FSHA							22	33	<b>55</b>
FSHK, FEK, FJ: E- qeversja					60	44	37	46	<b>187</b>
Juridik: QLSHD					50	28	22	34	<b>134</b>
Gjithsej	<b>1463</b>	<b>1286</b>	<b>1161</b>	<b>994</b>	<b>910</b>	<b>811</b>	<b>748</b>	<b>801</b>	<b>8174</b>

Prej 4904 studentëve të regjistruar deri në vitin 2016/17 kanë diplomuar gjithsej 1303 studentë, prej të cilëve 958 janë femra dhe 345 meshkuj, me një përqindje prej 26.6 %.

Nga shifrat e mësipërme shihet një rënie e lehtë latente e studentëve të regjistruar dhe kjo shpjegohet:

- Me proceset globale dhe rajonale të migrimëve, ku Kosova nuk bënë përjashtim;
- Sepse në dy vitet e para 2013-2014 janë regjistruar një numër i madh i studentëve, të cilët kanë kaluar nga Universiteti I Prishtinës në UKZ.
- Sepse në dy vitet e para 2013-2014 janë pranuar një numër më i madh i studentëve (sipas vendimit të MASHT për vendet e rezervuara për komunitetet)
- Politikat e UKZ për zvogëlimin e kuotave të studentëve të pranuar në disa fakultete, si në Fakultetin Ekonomik dhe në Fakultetin Juridik;

Konkurrenca për një vend të studentit në UKZ është e madhe: në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, në Fakultetin e Edukimit, në programet master, në Fakultetin e Shkencave Aplikative konkurrenca shkon 3-4:1, pra ka tre deri në katër kandidat për një vend të studentit. Në disa programe të tjera studimore, si në Fakultetin Juridik dhe Fakultetin Ekonomik konkurrenca është më e vogël.

Një interesim të veçantë UKZ i ka kushtuar edhe marrëdhënies numerike profesor-student. Kështu që tashmë kemi një marrëdhënie relativisht të mirë, të afërt me mesataren europiane: 1 staf akademik me 21 studentë (1:21). Shih këtë marrëdhënie në vitin 2020 tek standardi

Prejardhja socio-ekonomike e studentëve të UKZ-së ka dy karakteristika kryesore:

- Studentët e UKZ janë pothuajse të gjithë nxënës të cilat kanë kryer shkollimin e mesëm të lartë (12-vjeçar) dhe provimin e maturës (për të dy këto kualifikime merret



numër i caktuar i pikëve të cilave u shtohen pikët e fituara në provimin pranues që e organizojnë fakultetet përkatëse);

- Nuk hetohet ndonjë dallim drastik i gjendjes ekonomike të studentëve, duke pasur parasysh që pagesa për regjistrimin e semestrave është i pranueshëm për studentët;
- Për studentët me gjendje të vështirë ekonomike, komunat nga të cilat vijnë ata, ndajnë rregullisht bursa për studentë. Bursa për studentët e shkëlqyeshëm ndan edhe Universiteti, sikurse edhe MASH-i. Po ashtu edhe organizmat e tjerë, ndajnë bursa për kategori të studentëve të shkëlqyeshëm, për studentët me vështirësi ekonomike dhe të tjera;
- Numri më i madh i studentëve të cilët jetojnë jashtë Gjilanit, për t'i ndjekur ligjëratat dhe aktivitetet e tjera mësimore, udhëtojnë. Duke iu falënderuar pozitës së Gjilanit që është afër vendbanimeve të shumicës së studentëve dhe zhvillimit të hovshëm të kompanive të transportit publik, nuk hetohet ndonjë ngecje në këtë drejtim.

Vend të posaçëm në strukturat organizative i është kushtuar pjesëmarrjes së studentëve. Përfaqësimi i studentëve bëhet në të gjitha nivelet e menaxhimit të Universitetit dhe në të gjitha komisionet e përhershme.

Për organizimin e aktiviteteve të studentëve, menaxhmenti i UKZ-së ka siguruar përkrahje të plotë, duke siguruar hapësirë të nevojshme dhe logjistikë tjetër të nevojshme.

UKZ ka një stabilitet dhe qëndrueshmëri financiare afatgjatë, pasi si universitet publik financohet prej buxhetit të Republikës së Kosovës. Granti qeveritar është fond i lejuar nga buxheti i Kosovës, i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore.

Qëllimi i UKZ është edhe ta nxis Qeverinë e Kosovës që ta themelojë një fond suplementar për financimin e universiteteve publike në mënyrë jo-lineare: një fond në të cilin universitetet konkurrojnë dhe fitojnë grante në bazë të performancës së tyre hulumtuese, programe e të tjera.

• *Mësimdhënia, mësimi dhe kurrikula*

Mësimdhënia dhe mësimnxënia në programet studimore të UKZ bazohet, fillimisht në rregulloret e aprovuara nga ana e Senatit. Gjatë hartimit dhe përgatitjes së programeve studimore, e sidomos gjatë realizimit të procesit mësimor në këto programe, rol të rëndësishëm luan stimulimi dhe motivimi i studentëve në procesin mësimor, duke ofruar një varg të aktiviteteve: ofrimi i syllabuseve të lëndëve në fillim të semestrit, ligjëratat dhe ushtrimet me metoda fleksibile dhe me material të nevojshëm, organizimi i vlerësimeve periodike dhe të vazhdueshme, përdorimi i IT-së dhe aplikacionit e-learning, konsultimet e rregullta me mësimdhënësit etj. Në matjen e performancës së mësimdhënësve dhe të procesit



mësimor, indikatorët kryesorë janë: vlerësimi i studentëve dhe rezultatet e arritura të studentëve, monitorimi i rregullte i procesit mësimor etj.

Në ngritje të rolit mbikëqyrës të procesit akademik, menaxhmenti i UKZ ka vendosur në hyrjet e UKZ regjistrimin digjital për stafin akademik dhe stafin administrativ. Regjistrin e hyrje-daljeve të stafit e kontrollojnë dekanët e fakulteteve dhe sekretari gjeneral për administratën në baza javore, ndërsa gjetjet diskutohen edhe në takimet javore të rektorit me dekanët.

Mënyra e organizimit të procesit mësimor, si edhe vlerësimi i të arriturave të studentëve në studimet e programit master *Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe* bëhet konform rregullës në fuqi (shih shtojca: Rregullore për studimet master në UKZ)

Në Rregulloren e studimeve master, janë përcaktuar organizimi i studimeve, kohëzgjatja e studimeve, kushtet e regjistrimit, kriteret e kalueshmërisë në vitin vijues, ndryshimin e programit të studimeve, kalimin nga/në fakultetet e tjera, organizimi i provimeve, të drejtat dhe detyrat e studentit, organizimi i studentëve, përfundimi i studimeve dhe diplomimi i studentëve etj. (shih shtojca: Rregullore e studimeve master në UKZ).

Paraqitja e provimeve bëhet gjatë tri afateve të rregullta: në afatin e janarit - prej 15 deri më 20 janar, në afatin e qershorit - prej 1 deri më 5 qershor, në afatin e shtatorit - prej 20 deri më 30 gusht.

Mësimdhënësi është i detyruar që pas përfundimit të rezultateve përfundimtare të provimit, më së largu brenda 72 orësh t'ia dorëzojë zyrtarit të shërbimit të studentëve raportin e provimeve, bashkë me listën e studentëve si dhe kopjet fizike të fletëparaqitjeve të shkarkuara nga sistemi SMU. Format e mbajtjes së provimit janë: provimi me shkrim, provimi me gojë, provimi me shkrim dhe me gojë, provimi me test, provimi praktik dhe kolokuiumi.

Vlerësimi i provimit shprehet me notë:

**Tabela 4. Forma e notimit në UKZ**

Nota në UKZ	Përshkrimi me fjalë	Barasvlershme me Sistemin e Bolonjës
10	Shkëlqyeshëm	A
9	Shkëlqyeshëm	B
8	Shkumë mirë	C
7	Mirë	D
6	Mjaftueshëm	E
5	Pamjaftueshëm	F





Studentët duhet të arrijnë notën minimale 6 për kalueshmëri, që do të thotë se studentët duhet të arrijnë minimum 50 % të notës përfundimtare për lëndët përkatëse.

Roli vendimmarrës i studentëve në strukturat organizative të UKZ-së zhvillohet nga pjesëmarrja e tyre në organet vendimmarrëse: Bazuar në Statutin e UKZ-së, dy përfaqësues të studentëve janë anëtarë me të drejtë vote në Senatin e UKZ; në Këshillin Drejtues është një anëtar – student-vëzhgues; në Komisionin për studime dy studentë me të drejtë vote; në Këshillin e Fakultetit studentët janë të përfaqësuar me nga një anëtar për secilën njësi akademike, me të drejtë vote. Për organizimin e aktiviteteve të studentëve, menaxhmenti i UKZ-së ka siguruar përkrahje të plotë, duke siguruar hapësirë të nevojshme dhe logjistikë tjetër të nevojshme.

Organizimi i procesit mësimor në UKZ është gjithnjë në funksion të politikave të Qeverisë për arsimin e lartë në Kosovë. Të gjitha vendimet e sjella nga MASHT implementohen në UKZ.

Në UKZ zbatohet organizimi i kurrikulave (planprogrameve studimore) bazuar në sistemin e tri cikleve të arsimit të lartë, Sistemin Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) dhe zbaton të gjitha rekomandimet e procesit të Bolonjës.

Përcaktues i rëndësishëm i punës në Universitetin “Kadri Zeka” është Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit të UKZ-së 2017-2022, i miratuar në Këshillin Drejtues të UKZ në maj 2017.

## 2. VLERËSIMI I PROGRAMIT

### 2.1. Misioni, objektivat dhe administrimi

**Tabela 5. Pasqyra e programit për akreditim: Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe**

Emri i institucionit	Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan Fakulteti i Edukimit
Emri i programit	Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe
KKK Nivel (BA, MA, PhD etj.)	VII
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar	Master në mësimdhënie e gjuhës dhe letërsisë shqipe MA
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC)	09.9
Profili i programit (specializimi) akademik	/



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Kohëzgjatja minimale e studimit	2 semestra, 1 vit
Forma e studimit (e rregullt, pa shkëputje nga puna, studimi në distancë)	E rregullt
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	60
Lëndët (obligative dhe zgjedhore)	<p style="text-align: center;"><b>Semestri I</b></p> Didaktikë e gjuhës shqipe Didaktikë e letërsisë shqipe Mësimdhënia efektive Tipologjia e letërsisë shqipe Metodologji e hulumtimit shkencor Analizë e tekstit letrar Teknologji arsimore Estetikë Vlerësimi në arsim
	<p style="text-align: center;">Semestri II</p> Shqipja standarde dhe drejtshkrimi Letërsia bashkëkohore shqipe Praktikë e mësimdhënies (3 javë) Autorë të zgjedhur të letërsisë shqipe Letërsi krahasimtare Gjuhësi krahasimtare Arsimi gjithëpërfshirës Punimi i tezës së masterit
Numri i vendeve të studimit	40
Udhëheqësi i programit të studimit	Prof. asoc. dr. Merxhan Avdyli
Personeli i përhershëm akademik (Numri sipas kategorive të personelit)	<p style="text-align: center;">Profesor i rregullt</p> Prof. dr. Bajram Kosumi
	<p style="text-align: center;">Profesorë të asociuar</p> Prof. asoc dr. Merxhan Avdyli Prof. asoc. dr. Nevrije Ismaili
	<p style="text-align: center;">Profesorë asistentë</p> Prof. ass. dr. Emin Krasniqi Prof. ass. dr. Shpresë Qamili Prof. ass. dr. Voglushe Kurteshi Prof. ass. dr. Nerxhivane Krasniqi Prof. ass. dr. Mensur Neziri Prof. ass. dr. Kastriot Dërmaku
Taksa e studimit	125 euro për semestër



Në kuadër të Fakultetit të Edukimit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” është formuar grupi i punës, i cili ka bërë një hulumtim lidhur me numrin, kualifikimin dhe perspektivën e mësimdhënësve të gjuhës dhe letërsisë shqipe në veçanti në rajonin e Gjilanit dhe të Ferizajit. Duke u bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi është mësuar se vetëm në këto dy rajone të Kosovës, pas më pak se 5 viteve shtrohet nevojë urgjente e përtëritjes, përkatësisht zëvendësimit të kuadrit të pensionuar të mësimdhënësve të gjuhës dhe letërsisë shqipe, në mënyrë që arsimi i mesëm i ulët dhe arsimi i mesëm i lartë të mund të vazhdojnë përgatitjen e nxënësve për tregun e punës dhe arsimin universitar, duke konsideruar se arsimimi përgjithësisht është faktor kyç për zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë bashkëkohore. (Shih te shtojcat: *Pasqyra e pensionimit të kuadrit arsimor, periudha 2014-2024*).

Të dhënat lidhur me kuadrin arsimor të gjuhës shqipe nga rajoni i Gjilanit, rajoni i Ferizajit dhe nga Lugina e Preshevës rezultojnë se 206 mësimdhënës janë pensionuar ose do të pensionohen në periudhën kohore 2014-2024, që d.m.th. se për çdo vit ekziston nevoja për mbi 20 të diplomuar nga gjuha shqipe, pra ekziston nevoja e domosdoshme për kuadër të këtij programi. Në këtë numër nuk janë përfshirë edhe shkollat private, që funksionojnë në këto rajone (“Don Bosko”, “Aga Xhite”, “Hello Academy” etj.).

Situata është si në tabelën në vijim:

**Tabela 6. Numri i mësimdhënësve të gjuhës shqipe të pensionuar në 5 vitet e fundit dhe atyre që do të pensionohen në 5 vitet e ardhshme**

Nr.	Komunat	Mësimdhënës të gjuhës shqipe	
		Të pensionuar 2014-2019	Do të pensionohen 2019-2024
1	Gjilan	14	35
2	Kamenicë	8	20
3	Viti	13	22
4	Novobërdë	1	1
5	Ferizaj	12	21
6	Kaçanik	9	11
7	Hani i Elezit	-	1
8	Shtërpçë	1	3
9	Shtime	4	8
10	Bujanoc	7	1
11	Preshevë	10	4
	<i>Gjithsej</i>	79	127



Po kështu një grup tjetër punues ka bërë një hulumtim lidhur me alumnin, duke intervistuar studentët të cilët kanë diplomuar në të dy programet e Fakultetit të Edukimit. (Shih te shtojca: *Hulumtimi i alumnit*). Nga hulumtimi mund të kuptohet rëndësia e studimeve në Fakultetin e Edukimit, ndërkaq lidhur me programin konkret për të cilën aplikohet për akreditim mund të thuhet se shtrohet edhe nevoja për programin master në kuadër të Fakultetit të Edukimit, sepse një numër i konsiderueshëm i studentëve të cilët kanë diplomuar këtu i vazhdojnë studimet master në universitetet e tjera, duke arritur rezultate të mëdha.

***Vizioni i Fakultetit të Edukimit është: Përgatitja e profesionistëve të gatshëm për tregun e punës dhe në shërbim të nevojave të shoqërisë së zhvilluar dhe prosperuese.***

***Misioni i Fakultetit të Edukimit është: të promovojë te studentët hulumtim të vazhdueshëm të zhvillimit dhe edukimit, duke i kushtuar kujdes vlerave njerëzore dhe qytetare, vlerave universale, si edhe përfitim të një kulture të gjerë akademike në mënyrën e gjykimit dhe reagimit ndaj situatave të shoqërisë bashkëkohore dhe dinamike.***

Objektivat e përgjithshme të programit master ***Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe*** është si në vijim:

- Avancimi i kompetencave moderne të mësimdhënies dhe të praktikës pedagogjike, krahas atyre akademike, duke marrë për bazë edukimin paraprak dhe nevojat e profilit arsimor të mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe;
- Avancimi i kompetencave moderne të mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe të praktikës pedagogjike për kandidatët, që vijnë nga programet arsimore të fakulteteve akademike, me përgatitje adekuate akademike;
- Avancimi i kompetencave akademike për kandidatët e këtij programi, që vijnë nga Fakulteti i Edukimit, ku kompetencat e mësimdhënies janë të mjaftueshme, ndërsa nevojitet të plotësohen më tutje komponentët akademikë.

Programi master ***Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe*** u dedikohet grupeve të ndryshme të kandidatëve si target grupe:

- Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor në Fakultetin e Edukimit (240 ECTS);
- Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor në fakultete të tjera përkatëse arsimore (240 ECTS) dhe kanë pasur të paktën 20 ECTS të kurseve nga fusha e didaktikës;
- Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor, në Programin Gjuhë shqipe dhe në Programin Letërsi shqipe, me 240 ECTS;
- Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor në programin Gjuhë dhe letërsi shqipe, në Fakultetin e Edukimit, me 240 ECTS.



## Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administratën:

Programi i propozuar *Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe* në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan do të ofrojë një *qasje të re programore të procesit të përgatitjes akademike të mësimdhënësve të gjuhës dhe letërsisë shqipe*. Me këtë program synojmë që kjo qasje të jetë alternativë më e mirë dhe më bashkëkohore, duke u bazuar në faktin se rezultatet e mësimin të gjuhës dhe letërsisë shqipe në të gjitha nivelet e shkollimit në Kosovë nuk është e mjaftueshëm e kënaqshme (si referencë përdorim rezultatet e PISA 2016 dhe PISA 2019, sipas së cilave në lexim, që ka të bëjë pikërisht me mësimin e gjuhës dhe letërsisë nxënësit e Kosovës nuk treguan rezultate të kënaqshme në krahasim me vendet e tjera).

Stafi akademik i Fakultetit të Edukimit, i cili do të angazhohet në mësimdhënie në programin e masterit *Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe* është profesionalisht tejet i përgatitur dhe ka shënuar *rezultate, duke treguar një performancë të shkëlqyeshme*. Po kështu ata kanë publikuar punime shkencore, si dhe libra të veçantë studimor, qoftë brenda arealit gjuhësor shqiptar, qoftë edhe jashtë tij. Këto aktivitete garantojnë faktin që rezultatet e pritshme të studiuesve të gjuhës dhe letërsisë shqipe do të zbatohen në programin Mësimdhënie e gjuhës dhe letërsisë shqipe.

### A. Pikat e forta

- Misioni i programit master *Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe* është në harmoni me misionin e UKZ-së dhe të Fakultetit të Edukimit;
- Objektivat e caktuara janë reale dhe të arritshme, si dhe janë rezultat i konsultimeve brenda stafit të Fakultetit të Edukimit;
- Rezultatet e pritura të programit në tërësi dhe të lëndëve janë në përputhje me nivelin VII të Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve;
- Ecuria e realizimit të programit prej regjistrimit e deri te përfundimi, përkatësisht diplomimi, është e qarte dhe në përputhje me Statutin dhe rregulloret e UKZ-së;
- Fakulteti i Edukimit ka burime të mjaftueshme akademike, administrative dhe financiare për ta mundur realizimin e plotë të programit;
- Administrata e Fakultetit të Edukimit e mbështet programin, duke përfshirë edhe dosjen e studentit dhe progresin e tij gjër në përfundim të studimeve;



- Në Rregulloren për studime master janë paraparë procedurat, përkatësisht kushtet e pranimit të studentëve, përfshirë edhe procedura e ankimimit të studentëve në rast të pakënaqësive të tyre.

## B. Dobësitë

- Mungesa e programit baçelor të gjuhës dhe letërsisë shqipe në Fakultetin e Edukimit në UKZ.
- Vërehet një mungesë e disa mjeteve teknike mësimore.
- Objekti në të cilin vepron Fakulteti i Edukimit i përmbushë pjesërisht kriteret për personat me aftësi të kufizuara.
- Perceptimi se gjuha shqipe është e vështirë për t'u studiuar, për shkak të disa problemeve me drejtshkrimin, që vjen si pasojë e disa mangësive nga niveli paraprak i shkollimit.

## C. Mundësitë

- Programi master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe është alternativë e programit të Mësimdhënies dhe Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës, ndërkaq asnjë universitet tjetër publik nuk ka program masteri në mësimdhënie të gjuhës dhe letërsisë shqipe (institucionet e arsimit të lartë të sektorit privat sipas ligjeve të Kosovës në fuqi, nuk kanë të drejtë të nxjerrin mësimdhënës për asnjë nivel), atëherë programi ynë do të ishte një mundësi e mirë sidomos për studentët e rajonit të Gjilanit, Ferizajit, Luginës së Preshevës, për rajonin e Kumanovës (Maqedonia Veriore), por edhe të Republikës së Kosovës.
- Kërkesa nga kurrikula e re e cila kompetencën e komunikimit dhe të shprehurit e llogarit si një nga kompetencat kryesore. Plotësimi i kësaj kompetence parashihet të bëhet kryesisht nga mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe.
- Përgatitja e mësimdhënësve të gjuhës dhe letërsisë shqipe me njohuri bashkëkohore.
- Nevoja për ngritjen e cilësisë së komunikimit nëpër institucione, media, biznese.
- Është program atraktiv, sepse tërheq studentë edhe nga hapësira gjuhësore shqiptare jashtë Kosovës.
- Kualifikimi që merret me këtë program mundëson vazhdimin e studimeve në nivel PhD nga fusha e studimit të gjuhës dhe letërsisë.



## D. Sfidat

- Mungesë e pjesshme e fondeve për përkrahje të aktiviteteve hulumtuese e studimore.
- Kërkesat e vazhdueshme të drejtorive komunale të arsimit për përgatitjen e kuadrit nga kjo fushë.
- Pengesat e konkurrimit në tregun e punës jashtë Kosovës, në veçanti në Luginën e Preshevës prej nga vjen një numër i konsiderueshëm studentësh, sepse Serbia nuk i njeh diplomat e Republikës së Kosovës..

## 2.2. Menaxhimi i cilësisë

Preokupim kryesor i aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit është realizimi i studimeve cilësore në të gjitha aspektet e veprimtarisë akademike. Kjo do të arrihet së pari me respektimin e kornizës formale të përcaktuar nga Ligji mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Statuti i UKZ-së dhe aktet e tjera normative, që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Për këtë qëllim është hartuar Rregullorja për procedurat e sigurimit të cilësisë në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan dhe është themeluar Zyra për Cilësi dhe Zhvillim Akademik. (shih te shtojcat: *Rregulloren për procedurat e sigurimit të cilësisë dhe Standardet e sigurimit të brendshëm të cilësisë për UKZ-në*)

Rregullorja për procedurat e sigurimit të cilësisë në UKZ, është e bazuar në pajtueshmëri me *Standardet e Sigurimit të Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area ESG)*.

Rregullorja për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin në UKZ është rishikuar në vitin 2020 dhe e cila është miratuar nga Senati. Kjo rregullore përcakton sistemin e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin, mekanizmat dhe instrumentet e sigurimit të cilësisë, akterët e sigurimit të cilësisë dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në këtë proces. I gjithë procesi ka për qëllim përmbushjen e objektivave strategjike të UKZ-së.

Rregullore për themelimin dhe funksionimin e KMCV, Nr.01/2124, dt.08.12.2020, Ky është një organ këshillues, i cili në bashkëpunim me organet e tjera profesionale të UKZ, planifikon, harton, monitoron, analizon dhe administron procedurat e vlerësimin të procesit mësimor, hulumtimit shkencor dhe të gjitha vlerësimet e fushave të tjera që mbulohen nga UKZ. KMCV të UKZ ka hartuar MVP.

UKZ ka nxjerr edhe MVP. Qëllimi i MVP është të krijojë një mekanizëm për të ndihmuar stafin e UKZ-së që të zhvillohet gjatë procesit të ndërtimit të karrierës së tyre, që të



kontribuojë në cilësinë e punës në UKZ, si dhe të harmonizojë punën e tyre me objektivat strategjike.

Sa i përket aplikimit të instrumenteve në fushën e sigurimit të cilësisë, në mbledhjen e të dhënave janë të aplikuara forma të ndryshme, sikurse pyetësorë, anketat, intervista si dhe realizohen edhe monitorime gjatë mbajtjes së mësimit (Metodologjisë, përdorimit të teknologjisë, format e vlerësimit, çështjeve të transparencës).

UKZ nëpërmjet vlerësimeve të shumëfishta e bënë vlerësimin e cilësisë. Për këtë arsye UKZ ka hartuar edhe pyetësorët për të gjitha vlerësimet, ku vlerësohen stafi akademik, administrativ, shërbimet si dhe kushtet mësimore-infrastruktura:

UKZ dy vitet e fundit, për të realizuar hulumtimin ka përdorur një llojllojshmëri të pyetësorëve si në vijim:

1. Pyetësori për studentë lidhur me shërbimet administrative në UKZ
2. Pyetësori për studentët lidhur me mësimin online në UKZ
3. Pyetësori për staf akademik lidhur me mësimin online të UKZ
4. Pyetësori për studentë lidhur me vlerësimin e Profesorëve të UKZ
5. Pyetësori për studentë lidhur me vlerësimin e asistentëve të UKZ
6. Pyetësori për personelin akademik lidhur me vlerësimin e aspekteve të punës së tyre me studentë në UKZ
7. Pyetësori për personelin administrativ të UKZ lidhur me aspektet e tyre të punës, posaçërisht sugjerimet e tyre për përmirësime eventuale.
8. Pyetësori për vetëvlerësim të stafit akademik
9. Pyetësori për alumni
10. Pyetësori për vlerësim të jashtëm/ punëdhënësi

Kontrollimi i cilësisë bazohet edhe në Planin e Veprimit për Cilësi, i cili përditësohet çdo vit. Plani i Veprimit për Cilësi i parë është miratuar në vitin 2018. *Procesi i kontrollit dhe rritjes së cilësisë sipas këtij modeli ka disa faza gjatë Semestrit:*

- Faza e parë fillon në javën e parë të semestrit me hartimin e syllabusit-planit të punës nga mësimdhënësi, të detajuar se çka do të punojë ai (mësimdhënësi) në secilën javë gjatë semestrit. Syllabusi iu shpërndahet studentëve (në formë elektronike, në internet, ose si kopje në letër), ashtu që ata të jenë të informuar se çka do të punohet në çdo javë.
- Pas kësaj në çdo javë krijohen raportet e mbajtjes së mësimit të cilat duhet të përkojnë me syllabusin e dorëzuar në fillim të semestrit.
- Bëhet vlerësimi kolegu për kolegun, me anë të cilit zyrtari për cilësi bën një raport vlerësues për secilin mësimdhënës veç e veç, duke u bazuar edhe në vlerësimet e tjera të brendshme.





Në fund të semestrit apo përfundimit të vitit akademik, ashtu siç është e paraparë me *Rregulloren për Procedurat e Sigurimit e Cilësisë* hartohet raporti i vetëvlerësimit lidhur me cilësinë e studimeve në njësinë akademike të UKZ nga secili mësimdhënës.

Gjithashtu, në bashkëpunim me *Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi*, UKZ ka caktuar edhe Koordinatorët për Cilësi, në secilën njësi akademike nga një, të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi të rëndësishme në rrafshin e të siguruarit të cilësisë brenda njësisë akademike përkatëse. UKZ ka gjithsej 5 koordinatorë për cilësi.

Koordinatori i Cilësisë, anëtar i stafit akademik, është urë lidhëse në mes njësisë akademike dhe ZZHAC. Ai i raporton menaxhmentit dhe KF.

Koordinatori i Cilësisë ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Udhëzon stafin akademik dhe studentët në kuadër të njësisë akademike lidhur me aspektet praktike dhe akademike të zbatimit të ECTS-së;
- Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike, përkujdeset dhe monitoron përfshirjen e të gjitha palëve me interes (stafi akademik, studentëve, bizneseve, anëtarëve të Bordit këshillëdhënës, etj.), për hartimin/rishikimin e programeve të studimit gjatë procesit të ri/akreditimit;
- Është pjesë e planifikimit dhe monitorimit të procesit të vlerësimit të lëndëve dhe mësimdhënësve, si dhe vlerësimit të brendshëm të cilësisë;
- Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike ndihmon në sistemimin e të dhënave dhe informatave lidhur me aktivitetin shkencor/artistik në njësinë akademike (evidentimin e punimeve shkencore, performancës artistike, projekteve profesionale dhe shkencore);
- Këshillon, planifikon, dhe monitoron skema, aktivitete dhe veprimtari për ngritjen e cilësisë në njësinë akademike. Po ashtu, Koordinatori kujdeset për cilësinë e dokumenteve dhe informacioneve nga fusha akademike e fakultetit të publikuara në uebfaqe.

Të gjitha proceset e lidhura me sigurimin e cilësisë mbështeten nga menaxhmenti i institucionit në aspektin financiar dhe material me qëllim të realizimit të objektivave strategjike të vendosura me Planin Strategjik.

## **Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë:**

### **A. Pikat e forta**

- Fakulteti i Edukimit i posedon organizmat përkatës, burimet njerëzore dhe infrastrukturën ligjore për sigurimin e procesit të sigurimit të cilësisë;



- Stafi akademik i cili do të angazhohet në mësimdhënie në programin Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe është i përgatitur, ka përvojë dhe ka shënuar rezultate në fushat studimore dhe akademike;
- Studentë të shkëlqyer nga studimet baçelor të Fakultetit të Edukimit të UKZ kanë arritur rezultate të shkëlqyeshme edhe në universitet e tjera, në nivelet e studimeve master apo edhe në ato të doktoratës;
- Studentë të përkushtuar dhe të suksesshëm, për të cilët flasin të dhënat e hulumtimit alumni nga i cili duken qartë rezultatet dhe cilësia e studentëve që kanë diplomuar në UKZ dhe që janë punësuar në institucionet arsimore, qoftë në rajonin e Gjilanit, qoftë edhe në pjesët e tjera në Kosovë dhe ku vazhdimisht shënojnë rezultate të larta.
- Studentët e Fakultetit të Edukimit dhe të fakulteteve të tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë shqipe janë studentë të shkëlqyeshëm, e që mund të jenë kandidatë potencialë në programin master të mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe.
- Vullneti dhe gatishmëria e studentëve të diplomuar në Fakultetin e Edukimit për ngritje akademike e profesionale.
- Në kuadër të Fakultetit të Edukimit është funksional Instituti për Hulumtime dhe Trajnime Arsimore. Ai së fundmi është duke pilotuar projektin për më shumë se një mësues në klasat I-V të arsimit fillor, projekt ky i cili po realizohet në disa shkolla fillore të qytetit të Gjilanit.
- Ky program kontribuon në përgatitjen e mësimdhënësve në fushën e kurrikulës në gjuhë dhe komunikim.
- Zëvendësimi i mësimdhënies si memorizim me mësimdhënien që e nxitë mendimin kritik e krijues dhe vlerësimin e aftësive të individit për të argumentuar veprimet në situata të reja problemore;
- Ligjëratat, ushtrimet në klasë dhe tekstet do të jenë mjete për plotësimin e qëllimit. Programi master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe do të ofrojë një model tjetër mësimdhënie dhe nxënie;
- Komunikimi ndërmjet studentëve dhe mësimdhënësve nëpërmjet sistemit informativ të UKZ (*e-learning*);
- Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me fakultete simotra nga Republika e Shqipërisë dhe e Maqedonisë së Veriut, do të organizohen ligjëratat nga mësimdhënësit e ftuar dhe të njohur nga fusha e gjuhë dhe letërsisë shqipe.
- Ekziston një koordinim i mirë i të gjitha organeve dhe burimeve njerëzore, stafit akademik dhe studentëve në zhvillimin e proceseve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm;



- Është krijuar sistemi për sigurim të cilësisë;
- Është themeluar Zyra për Sigurim të Cilësisë;
- Është emëruar Koordinator i Cilësisë në kuadër të FED;
- Është formuar Këshilli Mbikëqyrës për Cilësi dhe Vlerësim;
- Është rishikuar rregullorja për Sigurim të Cilësisë, si dhe janë hartuar dokumente të tjera për vlerësim të stafit akademik. (Manuali për Vlerësim të SA, Treguesit e Performancës, Udhëzuesi për Vlerësim etj.).
- Ekziston një përvojë në menaxhimin e cilësisë, nga ana e stafit dhe e studentëve, që të gjithë së bashku të kontribuojnë në sigurimin e cilësisë.

## **B. Dobësitë**

- Fondet e kufizuara për realizimin e projekteve në bashkëpunim me studentët;
- Mjete teknike moderne të punës për implementimin e programeve studimore.

## **C. Mundësitë**

- Fakulteti i Edukimit ka përvojë në bashkëpunim në projekte të ndryshme ndërkombëtare, të cilat shfrytëzohen si mundësi e mirë për ngritjen e cilësisë
- Programi iu ofron studentëve filozofi të re të arsimit të karakterizuar me mënyrën e të kuptuarit të koncepteve, duke u mbështetur në dije të kuptuara si kapital intelektual, ku mësimdhënia e bazuar në memorizim, zëvendësohet me mësimin dhe hulumtimin që stimulon të mësuarit kritik;
- Studentëve të programit u mundësohet formë e re e komunikimit me mësimdhënësit nëpërmjet sistemit informativ (*e-learning*), i cili e lehtëson punën dhe krijon një sistem dinamik të studimit;
- Studentët e diplomuar në këtë program do të jenë mësimdhënësit të cilët sjellin frymë të re në arsimin e mesëm të ulët dhe mesëm të lartë të Kosovës dhe më gjerë;
- Krijimi i Qendrës Trajnuese për zhvillim të Stafit Akademik në Fakultetin e Edukimit;
- Zhvillimi i projekteve të ndryshme në kuadër të Institutit për Trajnime dhe Hulumtime Arsimore.



## D. Sfidat

- Për arsye të ndryshme administrative apo menaxheriale, krijohen disa vështirësi në realizimin e objektivave të programit studimor;
- Mosnjohja e mjaftueshme e gjuhëve të huaja.

## 2.3. Stafi akademik

Bazuar në dispozitat e nenit 8, paragrafi 3, pika 3.5 dhe nenit 13, paragrafi 2, pika 2.3 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe dispozitat e nenit 48, paragrafi I, pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit, Senati i UKZ-së, në takimin e mbajtur më 4.3.2019, miratoi Rregulloren për zgjedhjen e personelit akademik në UKZ. Kjo rregullore i përcakton kushtet e përgjithshme për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune të bazuara në Ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e UKZ-së, si dhe kriteret e veçanta për zgjedhjen e personelit akademik të nxjerra nga Senati i UKZ-së.

Procedurat për përzgjedhjen, punësimin dhe avancimin e stafit akademik janë të rregulluara me Statutin e UKZ. Vendimin për përzgjedhjen e stafit akademik e merr Senati i UKZ në bazë të propozimit të Këshillit të njesisë akademike, kurse emërimin e bënë rektori. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të ketë kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë në ndonjë universitet tjetër, kurse mosha e pensionimit të stafit akademik është 65 vjet..

I gjithë stafi akademik i paraparë për angazhim në programin master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe është i punësuar me normë të plotë në FE dhe i propozuar konform kualifikimeve të tyre në fushat specifike të edukimit. Stafi është vazhdimisht në përpjekjet për përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe aplikimit të teknologjisë informative në procesin mësimor, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

Në çdo vit akademik organizohet vlerësimi i cilësisë së mësimin dhe mësimdhënësve nga ana e studentëve, duke përdorur pyetësor anonim, të përgatitur nga Zyra për Cilësi, qëllimi i të cilëve është identifikimi i dobësive dhe përmirësimi i tyre.

**Tabela 7. Stafi akademik në programin Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe**

	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Grada akademike	Fusha e studimit	Kohëzgjatje e kontratës
1.	Bajram Kosumi	Dr. Sc.	Prof. Dr.	Letërsi/mediologji	4 vite



2.	Merxhan Avdyli	Dr. Sc.	Prof. Asoc.	Letërsi	4 vite
3.	Emin Krasniqi	Dr. Sc.	Prof. Ass.	Gjuhësi	4 vite
4.	Nevrije Ismaili	Dr. Sc.	Prof. Asoc.	Letërsi	4 vite
5.	Shpresë Qamili	Dr. Sc.	Prof. Ass.	Didaktikë e gjuhës	4 vite
6.	Bashkim Dalipi	Dr. Sc.	Prof. Ass.	Fizikë	4 vite
7.	Voglushe Kurteshi	Dr. Sc.	Prof. Ass.	Shkencat e edukimit	4 vite
8.	Nerxhivane Krasniqi	Dr. Sc.	Prof. Ass.	Psikologji arsimore	4 vite
9.	Mensur Neziri	Dr. Sc.	Prof. Ass.	Pedagogji	4 vite
10.	Kastriot Dërmaku	Dr. Sc.	Prof. Ass.	Teknologji informative	4 vite

Personeli i sipërhënuar është në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ, i ngarkuar edhe me lënde mësimore nga programet e tjera studimore. Bazuar në Statutin e Universitetit, procedura për përzgjedhjen e personelit dhe për emërimet e mësimdhënësve është si vijon: Pas identifikimit të nevojës për mësimdhënës nga njësitë akademike të universitetit, me miratimin e Senatit (dhe duke u konsultuar me MASHT-in, në fazën e organeve të përkohshme).

Rektori shpall konkurs të hapur në mjetet e informimit publik, ku përshkruhet vendi i punës dhe kushtet e nevojshme që duhet të plotësojë kandidati i cili konkurren.

Në njësinë akademike, për secilin vend të punës, formohen *komisionet recensuese* (prej 3 anëtarëve-anëtarët e komisionit duhet të kenë thirrje akademike relevante), të cilat shqyrtojnë dokumentacionet e kandidatëve, i intervistojnë ata për të cilët konsideron se është e nevojshme dhe ua propozojnë njësisë akademike. Propozimet e Komisionit recensues shqyrtohen në *Këshillin e Fakultetit* dhe nga aty dërgohen në *Komisionin për studime* të Senatit. Komisioni për studime shqyrton aspektin akademik, rezultatet shkencore të kandidatit, si dhe aspektet e tjera, të cilat sigurojnë cilësi në punën akademike të universitetit.

Pas kalimit në Komisionin për studime, procedura e emërimit bëhet nga *Senati i Universitetit* për periudhë 4-vjeçare për profesorë, profesorë të asociuar dhe profesorë asistentë. Për emërimin e ligjëruesve dhe asistentëve mësimorë, emërimi bëhet për periudhën 3-vjeçare. (shih te shtojcat: *Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik*).

Po kështu stafi akademik i nënshtrohet edhe rregullave të parapara me Kodin e etikës (shih te shtojcat: *Rregullore për Kodin e Etikës*).



## Analiza SWOT për stafin akademik:

### A. Pikat e forta

- Kualifikimi, cilësia dhe përvoja e stafit akademik të programit studimor;
- Përkrahja e menaxhmentit të UKZ-së në strukturimin e programit të ri;
- Angazhimi i stafit të ri akademik;
- Bashkëpunimi me mësimdhënës të njohur nga universitetet e hapësirës gjuhësore shqiptare;
- Rezultatet e studentëve të Fakultetit të Edukimit të UKZ-së në programet master të universiteteve të tjera brenda dhe jashtë Kosovës;
- Stafi është i mjaftueshëm në numër dhe me kualifikim përkatës;
- Pjesëmarrja e stafit akademik në projekte, konferenca shkencore dhe trajnime me universitetet ndërkombëtare që ndikojnë në zhvillimin profesional të tyre;
- Mbështetja e stafit akademik për projektet dhe hulumtime shkencore.

### B. Dobësitë

- Mungesa e stafit të mjaftueshëm mbështetës administrativ;
- Hapësira e kufizuar infrastrukurore për stafin akademik;
- Procedurat e vështira administrative në zhvillimin e aktiviteteve të shkëmbimit të personelit akademik ndërkombëtar;
- Përkrahje e paktë nga MASHT për zhvillimin e stafit.

### C. Mundësitë

- Intensifikimi i hulumtimeve shkencore nga fusha e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Kosovë dhe inkorporimi i tyre në rrjedhat e hulumtimeve evropiane;
- Krijimi i mundësive për hulumtues të rinj;
- Shkëmbimi i stafit dhe studentëve në programet ndërkombëtare.



## D. Sfidat

- Procedurat e komplikuar për rekrutimin e stafit akademik dhe administrativ.

## 2.4. Përmbajtja e procesit arsimor

Përshkrimi i programit të studimit (emri, orët javore, ECTS kreditë dhe statusi)

**Tabela 8. Informatat për programin e studimit në vlerësim: Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe**

Viti I					
Semestri I			Orë/javë		
Nr.	O/Z	Lëndët	L/u	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Didaktikë e gjuhës shqipe	3	5	Prof. ass. dr. Emin Krasniqi
2.	O	Didaktikë e letërsisë shqipe	3	5	Prof. asoc. dr. Merxhan Avdyli
3.	O	Mësimdhënia efektive	3	4	Prof. ass. dr. Voglushe Kurteshi
4.	O	Tipologjia e letërsisë shqipe	3	4	Prof. asoc. dr. Nevrije Ismaili
5.	O	Metodologji e hulumtimit shkencor	3	4	Prof. dr. Bajram Kosumi
6.	Z	Analizë e tekstit letrar	3	4	Prof. asoc. dr. Nevrije Ismaili
7.	Z	Teknologjia arsimore	3	4	Prof. ass. dr. Kastriot Dërmaku
8.	Z	Estetikë	3	4	Prof. dr. Bajram Kosumi
9.	Z	Vlerësimi në arsim	3	4	Prof. asoc. dr. Januz Dervodeli
*Studenti zgjedh 2 lëndë nga lista e lëndëve zgjedhore					
Semestri II					
Nr.	O/Z	Lëndët	L/u	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Shqipja standarde dhe drejtshkrimi	3	4	Prof. ass. dr. Emin Krasniqi
2.	O	Letërsia bashkëkohore shqipe	3	4	Prof. asoc. dr. Merxhan Avdyli
3.	O	Praktikë e mësimdhënies (3 javë)	3	4	Prof. ass. dr. Voglushe Kurteshi
4.	Z	Autorë të zgjedhur të letërsisë shqipe	3	4	Prof. dr. Bajram Kosumi
5.	Z	Letërsi krahasimtare	3	4	Prof. asoc. dr. Merxhan Avdyli
6.	Z	Arsimi gjithëpërfshirës	3	4	Prof. ass. dr. Mensur Neziri
7.	Z	Gjuhësi krahasimtare	3	4	Prof. ass. dr. Shpresë Qamili
8.	O	Punimi i tezës së masterit		10	
*Studenti zgjedh 2 lëndë nga lista e lëndëve zgjedhore					



Gjatë hartimit të programit kemi marrë në konsideratë programet e ngjashme të universiteteve evropiane, sepse konsiderojmë si kontribut të madh në fushën e arsimit prandaj edhe ky program duhet të arrijë dhe të përcjellë rrjedhat dhe rezultatet shkencore të këtyre universiteteve.

Nga shumë universitete të cilat përmbajnë në vete programe nga arsimit fillor kemi përzgjedhur dy universitete me të cilët e kemi shikuar krahasueshmërinë e programeve, ku kemi parë një përafri të tyre.

**Tabela 9. Krahasueshmëria e lëndëve në nivel ndërkombëtar**

Vendi	Universiteti	Fakulteti	Programi	Linku
SHBA	University of Northern Iowa	Department of Languages and Literatures	English with a Literature Emphasis	<a href="https://langlit.uni.edu/three-ma-english-emphases-and-ma-tess-teaching-english-secondary-schools">https://langlit.uni.edu/three-ma-english-emphases-and-ma-tess-teaching-english-secondary-schools</a>
Slovenia	Univerza v Mariboru	Filozofska fakulteta	Slovenski jezik in književnost	<a href="file:///C:/Users/Useri/Downloads/predmetnik_dv_ped_druga_slovenski_jezik_in_knjizevnost.pdf">file:///C:/Users/Useri/Downloads/predmetnik dv ped druga slovenski jezik in knjizevnost .pdf</a>

### Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit arsimor:

#### A. Pikat e forta

- Krahasueshmëria me programet e ngjashme ndërkombëtare
- Përfshirja aktive e stafit akademik në zhvillimin e programit.
- Rezultatet e pritura dhe të përshtatura me nivelin VII të Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve;
- Stafi akademik ka hartuar planet e kurseve (syllabuset), të cilat përmbajnë informata të hollësishme lidhur me procesin mësimor (përmbajtjen e lëndës, ngarkesën e studentit, metodat e vlerësimit, literaturën etj.);
- Përdorimi i mjeteve të teknologjisë informative për mbajtjen e procesit mësimor.





## B. Dobësitë

- Mungesa e disa sallave të digjitalizuara;
- Kanë munguar programet e studimeve të nivelit master;
- Tendenca e të rinjve për të fituar “kualifikime të lehta” dhe ikja nga studimet e mirëfillta dhe të qëndrueshme.

## C. Mundësitë

- Implementimi i objektivave të programit studimor promovon arsimin universitar të Kosovës në arenën evropiane dhe më gjerë;
- Rritja e bashkëpunimit të Fakultetit të Edukimit me universitetet e tjera rajonale, evropiane;
- Projektet ERASMUS, LECU, RESEARCH CULT, QATEK, QUADIC HERAS dhe projekte të tjera për shkëmbim të përvojave të stafit dhe të studentëve (Universiteti i Tetovës, Maqedoni; Universiteti i Korçës, Universiteti i Gjirokastrës, Universiteti i Elbasanit, Univeristeti i Durrësit, Shqipëri);
- Projekti i MASHT i fituar nga Instituti për Trajnime dhe Hulumtime Arsimore (ITHA).

## D. Sfidat

- Infrastruktura i plotëson pjesërisht kushtet e realizmit të programit;
- Zvogëlimi i vazhdueshëm numrit të mësimeve të gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollat e mesme të ulta dhe në shkollat e mesme të larta, për shkak të pensionimit të tyre (shih te shtojcat: Pasqyra e pensionimit të kuadrit arsimor, periudha 2014-2024).

## 2.5. Studentët

Procedurat dhe kriteret për pranimin e studentëve në programin master në Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe janë të rregulluara më Statutin e UKZ-së dhe Rregulloren për studimet master, dokumente këto të publikuara në uebfaqen e universitetit.

Në këtë program kanë të drejtë të konkurrojnë studentët që kanë gradën baçelor (240 ECTS) në edukim, në gjuhë shqipe, në letërsi shqipe ose në ndonjë program të ngjashëm.



Numri i studentëve të paraparë është 40, që garanton një efikasitet më të madh në ligjërata, në seminare dhe në punë praktike, apo edhe të punës së tyre në grupe. Mësimi organizohet në formë të rregullt dhe në fillim të programit çdo mësimdhënës është i obliguar që të paraqes syllabusin, të cilin duhet ta diskutojë me studentët. Në syllabuse janë të paraqitura edhe kontaktet e mësimdhënësit në mënyrë që të sigurohet komunikim i rregullt staf-student për çështjet akademike. Gjatë tërë procesit të studimeve studentët marrin edhe mbështetjen nga stafi administrativ, i cili regjistron provimet e kaluara në semestër dhe vit akademik dhe evidenton progresin e bërë nga semestri në semestër deri te diplomimi. Me Rregulloren e studimeve master është e paraparë edhe procedura e punimit të tezës master, si dhe kriteret për përmbajtjen e punimit. Studentët janë të organizuar në organizata studentore. Ata janë pjesë e të gjitha strukturave në UKZ, përfshirë senatin, komisionet për mësim, komisionet për sigurim të cilësisë etj.

Në bazë të Statutit të UKZ-së, dy përfaqësues të studentëve janë anëtarë me të drejtë vote të organit më të lartë të universitetit – Senatin; në Këshillin Drejtues është një anëtar-student vëzhgues; në Komisionin për studime dy studentë marrin pjesë me të drejtë vote; në këshillat e fakulteteve marrin pjesë me të drejtë vote përfaqësuesit e studentëve.

Për organizimin e aktiviteteve të studentëve, menaxhmenti i UKZ-së ka siguruar përkrahje të plotë, duke siguruar hapësirë të nevojshme dhe logjistikë tjetër të nevojshme.

Në bazë të buxhetit të UKZ-së, janë paraparë edhe bursa për studentët me notë të lartë mesatare, sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Drejtues i UKZ-së, ku të gjithë studentët e UKZ-së që kanë notën mesatare nga nota 9 (nëntë) janë përfitues të bursës dhe të cilët në afatet e rregullat i kanë përfunduar të gjitha provimet e viti paraprak.

Administrata e UKZ-së ka për qëllim që të jetë në shërbim të studentëve dhe të përpunojë dhe arkivojë me kujdes secilin dokument, i cili gjenerohet nga institucioni apo është pjesë e dokumentacionit të dosjes së studentit apo të punonjësit të institucionit. Kështu, administrata përveç që është përgjegjëse për dokumentacionin e stafit menaxhues, për dokumentacionin e mësimdhënësve të rregullt dhe të angazhuar, të dokumentacionit të punonjësve tjerë të institucionit, kujdeset edhe për:

- *Dokumentacionin e kandidatëve që paraqiten për regjistrim në UKZ,*
- *Dokumentacionin e studentëve të UKZ,*
- *Mbarëvajtjen dhe informimin me orarin e ligjëratave dhe të provimeve;*
- *Mbarëvajtjen e provimeve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për provime të studentëve,*
- *Bibliotekën e universitetit dhe pasurimin e saj me tekste të reja,*
- *Mirëmbajtjen e shërbimeve të internetit dhe shërbimeve të tjera që kanë të bëjnë me jetën studentore.*



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Pjesë e posaçme e punës së stafit akademik është orari i konsultimeve me studentë. Secili mësimsdhënës është i detyruar ta paraqesë në derën e kabinetit orarin e konsultimeve.

Bazuar në misionin e UKZ-së, preokupim kryesor i UKZ-së është përgatitja e studentëve për karrierë të suksesshme.

Pjesë e procesit mësimor në të gjitha fakultetet është mësimi praktik, për këtë arsye, UKZ ka lidhur marrëveshje me institucionet përkatëse për zhvillimin e mësimit praktik. Në këtë mënyrë, do të krijojmë të gjitha parakushtet që studentët tanë të kenë karrierë të suksesshme pas përfundimit të studimeve në UKZ-së.

Studentët gjatë diplomimit dhe pas diplomimit do të përfitojnë mundësi të vazhdimit të studimeve në nivelet e tjera në universitetet e tjera evropiane me anë të projekteve ERASMUS dhe të tjera.

Në kuadër të bashkëpunimit me projektet e programit ERASMUS+ dhe programet e tjera të shkëmbimit të studentëve, studentët e UKZ-së kanë përfituruar mobilitete studimore në universitete të ndryshme jashtë Kosovës. Aktualisht, UKZ është në partneritet me tri projekte të programit ERASMUS+, nga të cilat do të përfitojnë edhe studentët e programit Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Sa i përket Fakultetit të Edukimit studentët pos mësimit teorik, e kalojnë edhe fazën mësimit praktik, i cili realizohet jashtë kampusit të UKZ-së.

Studimet në Fakultetin e Edukimit në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjiilan organizohen në dy programe dhe atë në Programin Parashkollor dhe në Programin Fillor. Studimet zgjatën 4 vite, në të dy programet.

Mësimi praktik në dy programet për vitin e parë akademik, organizohet brenda institucionit të fakultetit dhe zgjat dy javë mësimore.

Studentët e vitit II, III dhe IV mësimin praktik e mbajnë në institucionet publike arsimore filllore, parashkollore dhe kopshte për fëmijë. Në këtë mënyrë studentët e vitit të dytë ngarkohen me 4 javë mësim praktik, ata vitit III me 6 javë, ndërkaq studentët e vitit IV me 8 javë mësim praktik. Mësimi praktik organizohet në koordinim dhe sipas marrëveshjes me drejtoritë komunale të arsimit, drejtorët e shkollave, dhe mësimsdhënësit, mentorë të trajnuar. Mbikëqyrja dhe vlerësimi i studentëve bëhen sipas udhëzuesit për praktikën pedagogjike. (shih shtojca: Udhëzuesi i praktikës pedagogjike)

Edhe në programin master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe do të organizohet mësimi praktik, në semestrin II, me 3 javë. Mbikëqyrja dhe vlerësimi i studentëve gjatë praktikës do të bëhet sipas doracakut (shih shtojca:

*Doracak për mësimin praktik për studentët e programeve master në Fakultetin e Edukimit).*



## Analiza SWOT për studentët:

### A. Pikat e forta

- Studentë pas përfundimit të studimeve baçelor në Fakultetin e Edukimit në UKZ kanë arritur rezultate të shkëlqyeshme edhe në universitet e tjera, në nivelet e studimeve master apo edhe në ato të doktoratës;
- Studentë pas përfundimit të studimeve baçelor në Fakultetin e Edukimit në UKZ janë punësuar si dhe janë duke treguar rezultate të mira në institucionet shkollore ku punojnë. (Shih te shtojcat: *Hulumtimi për alumni*);
- Studentët e Fakultetit të Edukimit dhe të fakulteteve të tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë shqipe janë studentë të shkëlqyeshëm, e që mund të jenë kandidatë potencialë në programin master të mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe;
- Studentë të përkushtuar dhe të suksesshëm, për të cilët flasin të dhënat e hulumtimi alumni nga i cili duken qartë rezultatet dhe cilësia e studentëve që kanë diplomuar në UKZ-së dhe që janë punësuar në institucionet arsimore, qoftë në rajonin e Gjilanit, qoftë edhe në pjesët e tjera në Kosovë dhe ku vazhdimisht shënojnë rezultate të larta;
- Përfshirja e studentëve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në UKZ.
- Studentët që arrijnë rezultate të mira mund të marrin bursa universitare;
- Studentë me notën më të lartë mesatare marrin mirënjohjen “Student i dalluar”.

### B. Dobësitë

- Sikurse për të gjitha nismat, edhe nisma e këtij programi mund të përcillet me vështirësitë të ndryshme. Ato mund të jenë të karakterit promovues, të shprehjes së mosbesimit apo dyshimit në arritjen e objektivave të cilat mund të ndikojnë në mosinteresimin e studentëve për studime në këtë program.

### C. Mundësitë

- Mundësitë e mëdha të punësimit pas kryerjes së studimeve do të jetë motiv i mirë për tërheqjen e studentëve për të studiuar dhe për të arritur rezultate të mira në studime;



- Studentët e këtij programi do të kenë mundësinë të fitojnë kualifikime të cilat sigurojnë punësim të tyre dhe ushtrim të suksesshëm të profesionit të mësimdhënësit bashkëkohor;
- Kërkesat e tregut të punës për këtë profil mësimdhënësish;
